



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK SHKODËR**

Nr. 308 Prot

Shkodër, më 02.06.2025

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”; të Udhëzimit nr. 759, datë 30.9.2024 “për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit” dhe Udhëzimit nr. 3, datë 7.2.2025 “Për marrjen në punë të punonjësve me kohë të pjesshme, në qendrat e formimit profesional publik dhe shkollat e mesme profesionale”, Ofruesi publik i AFP-së, Qendra e Formimit Profesional Publik Shkodër, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

-Instruktori i praktikës profesionale me kohë të pjesshme për kursin “Servis motori në automjete të lehta” (1 instruktor)

a) Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/ kualifikimet profesionale, për të cilin/ cilat po aplikon;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

1. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në);
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm;

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës13.06.2015

DREJTOR

